REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr. 544 Prot.

Lushnje më, 14/01/2026

R E L A C I O N

KESHILLIT BASHKIAK

"MBI SHPËRBLIMIN E SPORTISTES GEA DOKOLLARI DHE TRAJNERIT TË SAJ AMARILDO GJYLA"

Të nderuar zoterinj këshilltarë!

Sporti i peshëngritjes është përfaqësuar zyrtarisht në Lojërat Olimpike moderne që nga fillimi në 1896 dhe në Sidnei në vitin 2000 u bë si sport përfshirës edhe pë gjininë femërore. Në Lushnje është hapur për herë të parë ekipi i peshëngritjes në vitin 1985 me sportistë të grupit U-14. Ndër vite ekipi i peshëngritjes ka arritur të marrë kupa të ndryshme si në rang kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Pranë Bashkisë Lushnje ka ardhur kërkesa nga Federata Shqiptare e Peshëngritjes, për shpërblimin e sportistes Gea Dokollari e shpallur kampione në Kampionatin Kombëtar "Kupa e Republikës për të rritur" në ambientet e Pallatit të Sportit *"Feti Borova"* në Tiranë,

Ajo arriti rezutate të rëndësishme në kategroinë 69 kg dhe medalje ari në kategoritë: *stili i shkëputjes 80 kg, stili i shtytjes 92 kg dhe totali i dygarëshit 172 kg* dhe në këto kategori ka edhe rekord kombëtar, me trajner z. Amarildo Gjyla.

Fondi për shpërblimin e sportistes që ka fituar Rekord Kombëtar është *200,000 (dyqindmijë) lekë*, dhe shpërblimi i trajnerit z. Amarildo Gjyla që do të shkoj në masën 40% të vlerës që përfiton sportisti,e cila është *80,000 (tetëdhjetëmijë) lekë.*

Ju propozojmë miratimin e ketij projekt-vendimi.

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr. 544/1 prot.

Lushnje, më 14/01/2026

PROJEKT-VENDIM

NR. 09 DATË 14/01/2026

"MBI SHPËRBLIMIN E SPORTISTES GEA DOKOLLARI DHE TRAJNERIT TË SAJ AMARILDO GJYLA"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/____/2026, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Kryetarja e Bashkisë "Mbi shpërblimin e sportistit Laurenc Hasko dhe trajnerit të saj Amarildo Gjyla", si dhe mbeshtetur ne ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 25 pika 1,neni 54 germa "n" dhe V.K.M. Nr. 789 datë 15.12.2021 *"Për kriteret, mënyrën e shpërblimint dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre,i përditësuar"* pikat 4, 7 dhe 15 dhe neni 39 pika 2 i ligjit nr 79/2017 "Për Sportin,"i ndryshuar,

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë shpërblimin me vlerë prej *200,000 (dyqindmijë)* lekë për sportisten Gea Dokollari dhe në masën 40% të vlerës që përfiton sportisti *80,000 (tetëdhjetëmijë)* lekë për trajnerin Amarildo Gjyla.
2. Në Aparatin e Bashkisë do të pakësohet Fondi Rezervë *(me kod 00-01-AF129-604-V491AAA)* në vlerën *280,000 (dyqindetetëdhjetëmijë) lekë* dhe shtohen në Qëndrën e Kulturës dhe Klubi i Shumësporteve, Programi *"Disiplinat e ndryshme sportivve të mbështetura" (me kod 00-01-AE129-602-V813AAB)* për *280,000* (dyqindetetëdhjetë mijë) lekë .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Qendra Kulturore dhe Klubi Shumësportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ***(dhjetë)*** ditë pas shpalljes.

Drejtoria e Q.K.K.S.
Brizida Dervishi

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com